



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Bordi

**VENDIM**

**Nr. 41, Datë 23.02.2018**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE  
OPERACIONALE PËR FURNIZUESIN E MUNDËSISË SË FUNDIT, TË GAZIT  
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nenit 90, pika 10 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe neneve 19, pika 1, gërma “f” dhe 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016,”; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave Operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit, të gazit natyror”,

**Konstatoi se:**

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 90, pika 10 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE miraton “Rregullat operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit, të gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave Operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit, të gazit natyror.”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**